

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Rruga Migjeni (ish Banka e Ljubljanes), Kati V, Prishtinë

ANKESË

Ankuesi: INSPIRED TECH SH.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, NUI 810120882, me seli në rr. Bardhyl Çausi, Ob C15/10, Nr. 3, 10000 Prishtinë, e përfaqësuar nga Fatos Halilaj, drejtor; tel. +383 49 370 592; e-mail: info@inspired-tech.info.

Autoriteti Kontraktues: MINISTRIA E SHËNDETËSISË – Divizioni i Prokurimit, rr. e Zagrebit p.n., Prishtinë.

Aktiviteti i prokurimit: “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ”, nr. i prokurimit 206-25-4780-2-1-1; procedurë e hapur; lloji i kontratës: shërbime; vlera e parashikuar 168,000.00 €.

Aktet e kontestuara:

1) Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 08.09.2026, me të cilin kërkesa për rishqyrtim e OE Inspired Tech SH.P.K. e datës 07.09.2026 është refuzuar si e jashtëafatshme dhe është vërtetuar Njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 02.09.2026;

2) Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 02.09.2026 dhe B58 – Njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 02.09.2026, me të cilat është anuluar rekomandimi për kontratë ndaj OE Inspired Tech SH.P.K. i datës 20.08.2026 dhe është rekomanduar OE PBC SH.P.K.

Baza ligjore: nenet 105, 106, 108/A, 109 dhe 111 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar.

I. PRANUESHMËRIA E ANKESËS

1.1 Legjitimiteti procedural

Ankuesi është operator ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi, i cili me Vendimin e AK-së të datës 20.08.2026 ishte rekomanduar për dhënie të kontratës dhe i cili, me aktet e kontestuara, është eliminuar nga procedura. Rrjedhimisht, ankuesi është palë e interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 26 i LPP-së dhe ka interes juridik të drejtpërdrejtë për të atakuar aktet e lartcekura.

1.2 Procedura paraprake është zhvilluar

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues më datë 07.09.2026, mbi të cilën Autoriteti Kontraktues ka vendosur me Vendimin e datës 08.09.2026. Me këtë, kushti i procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, i kërkuar me nenin 109 paragrafi 1 të LPP-së, është përmbushur. Vetë Autoriteti Kontraktues, në pjesën “Këshilla juridike” të Vendimit të datës 08.09.2026, e ka udhëzuar shprehimisht ankuesin se kundër atij vendimi mund të paraqitet ankesë pranë OSHP-së brenda 10 (dhjetë) ditëve.

1.3 Afati

Vendimi i kontestuar është marrë më 08.09.2026. Kjo ankesë parashtrohet brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditësh nga pranimi i tij, konform nenit 109 paragrafi 1 të LPP-së dhe udhëzimit të vetë Autoritetit Kontraktues.

II. KONSTATIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR JASHTËAFATSHMËRI ËSHTË I PABAZUAR

Me Vendimin e datës 08.09.2026, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën tonë pa e shqyrtuar fare në përmbajtje, duke u mbështetur vetëm në nenin 108/A paragrafi 8.1 të LPP-së. Ky konstatim mbështetet në një premisë faktike të pasaktë – caktimin e datës 02.09.2026 si ditë “zero” – dhe si i tillë është i pabazuar, për arsyet në vijim.

2.1 B58-shi është publikuar pas orës 16:00 – dita “zero” nuk mund të jetë 02.09.2026

Në platformën e-Prokurimi, dokumenti “B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK.pdf” figuron i publikuar më datë 02.09.2026 në orën 16:10, pra dhjetë minuta pasi kishte kaluar ora 16:00. Ky fakt është drejtpërdrejt i verifikueshëm nga eksperti shqyrtues, i cili ka qasje në gjurmën elektronike të këtij aktiviteti të prokurimit, dhe ankuesi i propozon Panelit Shqyrtues ta konstatojë atë nga vetë sistemi, konform neneve 113 dhe 114 të LPP-së.

Neni 5.1 i LPP-së përcakton se afatet kohore të këtij ligji “duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune” dhe se “afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit”. Ora 16:00 është, pra, momenti ligjor në të cilin mbyllet dita procedurale për efekt të afateve të LPP-së. Një ditë e cila, në çastin e publikimit të njoftimit, ishte tashmë e mbyllur në kuptimin procedural, nuk mund të llogaritet si ditë “zero” e afatit pesëditor. Në të kundërtën, afati ligjor prej pesë ditësh i shkurtohet operatorit ekonomik në katër ditë, shtatë orë e pesëdhjetë minuta – rezultat që as ligji dhe as Rregullorja nuk e lejojnë.

Ky interpretim konfirmohet nga vetë arsyetimi i Autoritetit Kontraktues. Në Vendimin e datës 08.09.2026, ai e ilustron rregullin me shembullin: “Nëse B58 ‘Njoftimi mbi vendimin e AK-së’ është publikuar me datë 20.10.2023 para orës 16:00. Afati fillon të kalkulohet nga dita e nesërme e publikimit...”. Shembulli i vetë Autoritetit Kontraktues, pra, e kushtëzon shprehimisht trajtimin e ditës së publikimit si ditë “zero” me publikimin e bërë para orës 16:00. Rasti konkret nuk është i tillë, dhe Autoriteti Kontraktues e ka zbatuar rregullin mbi një premisë që në këtë lëndë nuk ekziston.

Llogaritja e drejtë e afatit është kjo:

- dita “zero”: 03.09.2026 (e enjte);
- dita e parë: 04.09.2026 (e premte);
- dita e dytë: 05.09.2026 (e shtunë);
- dita e tretë: 06.09.2026 (e diel);
- dita e katërt: 07.09.2026 (e hënë);
- dita e pestë dhe e fundit: 08.09.2026 (e martë), deri në orën 16:00.

Kërkesa për rishqyrtim e ankuesit është dorëzuar më 07.09.2026, pra në ditën e katërt të afatit, një ditë të plotë para skadimit të tij. Rrjedhimisht, ajo është parashtuar brenda afatit ligjor dhe refuzimi i saj në bazë të nenit 108/A paragrafi 8.1 të LPP-së është i pabazuar.

Së fundi, vërejmë asimetrinë në zbatimin e së njëjtës normë: Autoriteti Kontraktues e zbaton orën 16:00 në mënyrë rigoroz ndaj operatorit ekonomik, duke ia refuzuar kërkesën, ndërsa ndaj aktit të vet – të publikuar në orën 16:10, pra pas asaj ore – e trajton të njëjtën ditë si ditë të plotë procedurale, madje si ditë “zero” të

afatit. E njëjta dispozitë nuk mund të prodhojë pasoja vetëm ndaj njëres palë. Ky trajtim asimetrik është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

2.2 Këshilla juridike e vetë Autoritetit Kontraktues e ka udhëzuar ankuesin ndryshe

Vendimi i datës 02.09.2026 – akti me të cilin ankuesi u eliminua nga procedura – përmban një udhëzim të vetëm juridik: “Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.” Ai akt nuk përmban asnjë udhëzim për afat pesëditor të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

Pozita e Autoritetit Kontraktues është, pra, e vetëkundërshtueshme: ose udhëzimi i dhënë prej tij ishte i saktë – dhe atëherë rruga e vetme e ankuesit ishte pikërisht ankesa në OSHP, e cila paraqitet me këtë shkresë brenda afatit – ose udhëzimi ishte i pasaktë, dhe atëherë pala nuk mund të pësojë pasoja procedurale nga udhëzimi me shkrim i vetë autoritetit publik. Parimi i sigurisë juridike dhe neni 7 i LPP-së (transparenca dhe trajtimi i barabartë) e ndalojnë që një udhëzim i mangët i autoritetit t’i kthehet në disfavor palës që i është përmbajtur atij.

2.3 Neni 108/A.3.2 e lidh afatin me njoftimin e dërguar palës, jo thjesht me publikimin

Neni 108/A paragrafi 3.2 i LPP-së e përcakton afatin pesëditor “pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ... që i është dërguar ankuesit”. Ligji, pra, e lidh fillimin e afatit me njoftimin e dërguar palës. Neni 60.1(b) i Rregullores, i cili e vendos publikimin si ditë “zero”, është akt nënligjor dhe nuk mund të ngushtojë të drejtën e përcaktuar me ligj. Ankuesi propozon që të verifikohet data dhe ora kur njoftimi elektronik i është dërguar dhe ka qenë i qasshëm operatorit ekonomik në llogarinë e tij në platformë.

2.4 Platforma e ka pranuar dorëzimin si të vlefshëm

Platforma elektronike e prokurimit publik e ka pranuar dhe protokolluar kërkesën e ankuesit më datë 07.09.2026, pa e bllokuar dorëzimin dhe pa asnjë paralajmërim se afati kishte skaduar. Kur vetë sistemi elektronik i vënë në dispozicion nga institucionet e pranon dorëzimin si të vlefshëm brenda ditës së pestë, operatori ekonomik ka pritur legjitimitet se veprimi i tij procedural është i rregullt.

2.5 Pasoja e refuzimit thjesht formal

Ky është aktiviteti i prokurimit për të cilin OSHP ka nxjerrë katër vendime (nr. 2025/0883, nr. 1270/25, nr. 2026/0188 dhe nr. 2026/0420). Refuzimi i kërkesës vetëm mbi një bazë formale – me një diferencë prej pak orësh brenda ditës së fundit – bën që një vendim i cili bie ndesh me konstatimet e vetë Autoritetit Kontraktues të datës 20.08.2026 t’i shpëtojë çdo kontrolli merititor. Kjo është në kundërshtim me qëllimin e nenit 108/A, i cili synon zgjidhjen efektive të mosmarrëveshjeve, e jo mbylljen e tyre në mënyrë formale.

III. FAKTET DHE KRONOLOGJIA

- 18.07.2025 – Afati i fundit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave. Ankuesi ka dorëzuar ofertën me tërë dokumentacionin e kërkuar me Dosjen e Tenderit, përfshirë diplomat, CV-të dhe kontratat/marrëveshjet e angazhimit për tërë stafin e propozuar.
- 22.07.2026 – Me Vendimin nr. 2026/0420, OSHP e kthen aktivitetin në rivlerësim dhe e obligon Autoritetin Kontraktues të kërkojë sqarime shtesë dhe të bëjë analizimin e nevojshëm.
- 13.08.2026 – Autoriteti Kontraktues nxjerr Letrën Standarde B47 të kërkesës për sqarimin e tenderit, me të cilën, duke u thirrur shprehimisht në nenet 52.7 dhe 72 të LPP-së, kërkon nga ankuesi: “Referenca ose vërtetime nga punëdhënësi/klienti ku specifikohet qartë se projektet e menaxhuara janë zhvilluar në platformën Microsoft (.NET me SQL Server); Ose dokumentacion tjetër relevant që dëshmon

teknologjinë e përdorur në projektet e deklaruar”, me paralajmërimin: “Pa përgjigjen nga ana e juaj ... tenderi i juaj do të refuzohet.”

- 14–17.08.2026 – Ankuesi dorëzon, brenda afatit, sqarimin e plotë me anekset përkatëse – pra saktësisht formën e dëshmisë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 20.08.2026 – Autoriteti Kontraktues konstaton se sqarimet janë kërkuar “me qëllim të qartësisht, konkretizimit dhe verifikimit të dëshmive dhe informatave të nevojshme” dhe se ankuesi “është përgjigjur duke ofruar sqarime dhe dëshmi të mjaftueshme, sipas të cilave vërtetohet se i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në NJK dhe DT”. Ankuesi rekomandohet për kontratë.
- 24.08.2026 – OE PBC SH.P.K. parashtroi kërkesë për rishqyrtim.
- 02.09.2026 – Autoriteti Kontraktues e pranoi kërkesën e PBC-së, anuloi njoftimin e datës 20.08.2026, eliminon ankuesin dhe rekomandon PBC SH.P.K.
- 07.09.2026 – Ankuesi parashtroi kërkesë për rishqyrtim përmes platformës e-Prokurimi.
- 08.09.2026 – Autoriteti Kontraktues e refuzoi kërkesën si të jashtëafatshme, pa e shqyrtuar në përmbajtje.

IV. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar:

- Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi dhe transparenca;
- Neni 59, paragrafët 2 dhe 4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale;
- Neni 72, paragrafët 1, 2 dhe 3 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;
- Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve;
- Neni 131, lidhur me nenet 105 dhe 117 – moszbatimi i vendimit të OSHP-së.

Rregullorja nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. 002/2024:

- Neni 38, paragrafët 1, 3 dhe 5;
- Neni 60, paragrafi 1, pika b) – në lidhje me caktimin e ditës “zero”;
- Neni 63 – vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim.

V. PRETENDIMET ANKIMORE NË MERITA

5.1 Autoriteti Kontraktues e ka ndryshuar qëndrimin e vet brenda 13 ditësh, pa asnjë fakt të ri

Më 20.08.2026 Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se dëshmitë e ankuesit ishin “të mjaftueshme” dhe se “vërtetohet se i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në NJK dhe DT”. Më 02.09.2026, mbi të njëjtin dokumentacion – pa asnjë provë, dokument apo fakt të ri – i njëjti Autoritet Kontraktues i ka cilësuar po ato dokumente si ndryshim material të ofertës. I njëjti dokumentacion nuk mund të jetë njëkohësisht “dëshmi e mjaftueshme” dhe “ndryshim material”. Vendimi i datës 02.09.2026 nuk përmban asnjë arsyetim për këtë ndryshim qëndrimi, çka e bën atë arbitrar dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe nenin 63 të Rregullores.

5.2 Neni 38.3 është zbatuar në dy mënyra të kundërta brenda të njëjtit vlerësim

Në po të njëjtin vendim, Autoriteti Kontraktues e ka pranuar Aneksin 1 (referenca e QEP-së) “si sqarim sipas nenit 38.3 të Rregullores”, ndonëse ai dokument është lëshuar më 14.08.2026, pra pas afatit të ofertimit, dhe i shton deklaratimit ekzistues periudhën dhe teknologjitë. Njëkohësisht, Aneksin 2 (Albasoft) dhe Aneksin 4

(Inspired Tech) – të lëshuar në të njëjtën datë, me natyrë juridike identike dhe me të njëjtin funksion provues ndaj angazhimeve të deklaruar në CV brenda afatit – i ka refuzuar.

Duke e pranuar Aneksin 1, Autoriteti Kontraktues e ka pranuar shprehimisht parimin se një dokument i lëshuar pas afatit mund të dëshmojë ligjërisht një gjendje që ka ekzistuar para afatit. Mospranimi i të njëjtit parim për anekset e tjera, brenda të njëjtit vlerësim dhe të njëjtit vendim, përbën trajtim të pabarabartë dhe shkelje të nenit 7 të LPP-së.

5.3 Dokumentet janë dorëzuar sepse i ka kërkuar vetë Autoriteti Kontraktues

Asnjë prej anekseve nuk është dorëzuar në mënyrë spontane. Të gjitha janë përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj Letrës Standarde B47 të datës 13.08.2026, e cila kërkonte pikërisht “referenca ose vërtetime nga punëdhënësi/klienti” dhe paralajmëronte refuzimin e tenderit në rast mospërgjigjeje. Autoriteti Kontraktues e ka bërë atë kërkesë duke u thirrur në nenet 52.7 dhe 72 të LPP-së dhe në zbatim të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0420. Penalizimi i operatorit ekonomik për dorëzimin e dokumentit që vetë autoriteti e ka kërkuar prej tij – nën kërcënimin e refuzimit – e zbraz nga çdo kuptim mekanizmin e nenit 38 dhe të nenit 72 të LPP-së.

5.4 Menaxheri i Projektit – Ernest Culaj (Kërkesa 2.a)

1. Asnjë punëdhënësi, pozitë apo periudhë e re nuk është shtuar pas afatit. Të gjitha angazhimet mbi të cilat mbështetet kualifikimi janë deklaruar në CV-në e dorëzuar më 18.07.2025: Albasoft – Software Engineer (04/2009–12/2010), Chief Software Architect (01/2011–12/2012), Deputy Director (01/2013–09/2022), CEO (09/2022–në vazhdim); QEP – Project Manager (09/2019–08/2023); Don Bosko – CTO (09/2013–09/2018); Albatag – Zëvendësudrejtor (11/2019–12/2024). Aneksi 2 dëshmon çfarë është punuar dhe me çfarë teknologjie brenda pozitave dhe periudhave tashmë të deklaruar, pra pikërisht “gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit” në kuptim të nenit 38.3.
2. Ankuesi nuk pretendon se emrat e projekteve figurojnë si listë në CV. Në CV brenda afatit figurojnë punëdhënësit, pozitat dhe periudhat – pra vetë përvoja e punës; Aneksi 2 e konkretizon përmbajtjen dhe teknologjinë e asaj përvoje. Ky është dallimi ndërmjet dëshmimit të një fakti ekzistues dhe krijimit të një fakti të ri, dhe rasti konkret bie qartazi në të parin.
3. Dosja e Tenderit kërkon “përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme”, dhe jo një pozitë me emërtimin “Project Manager”. Kufizimi i llogaritjes vetëm te pozita me këtë emërtim i shton kriterit një kusht që Dosja e Tenderit nuk e përmban dhe përbën ndryshim të vetë kriterit pas hapjes së ofertave, në kundërshtim me nenet 7, 59 dhe 69 të LPP-së.
4. Përmbajtja menaxheriale rezulton nga vetë CV-ja e dorëzuar brenda afatit: për pozitën Chief Software Architect deklarohen shprehimisht detyrat “Manage IT department”, “Lead, direct and grow the software development team”, “Define and manage the Company’s product roadmap, translating business requirements and strategy into plans for the software engineering team” dhe “Supervise project management”.
5. Aneksin 1, të cilin Autoriteti Kontraktues e ka pranuar, dhe Aneksin 2, të cilin e ka refuzuar, i ka nënshkruar i njëjti person i autorizuar. Kredibiliteti i të njëjtit lëshues nuk mund të pranohet për njërin dokument dhe të mohohet për tjetrin. Ankuesi jep pëlqimin e plotë dhe të pakushtëzuar për verifikim të drejtpërdrejtë të lëshuesit, konform nenit 72 të LPP-së.
6. Elementi i certifikimit është i përmbushur: certifikata PMP nr. 3976191 është valide (16.11.2024–16.11.2027) dhe e verifikueshme në regjistrin publik të PMI-së. Dosja e Tenderit nuk kërkon që vetë certifikata të dëshmojë platformën teknologjike.

5.5 Zhvilluesja e Softuerit – Diana Llugaxhija (Kërkesa 2.b)

7. Vetë Autoriteti Kontraktues konstaton në vendim: “Nuk kemi kundërthënie, por mungesë dëshmie.” Rrjedhimisht, për këtë anëtare nuk qëndron as pretendimi për ndryshim material të ofertës, as ndalesa e nenit 38.2 apo 40.8 të Rregullores. Çështja e vetme është plotësimi i dëshmisë për një fakt që ka ekzistuar para afatit.
8. Fakti bazë është i padiskutueshëm dhe i dorëzuar brenda afatit: CV-ja e dorëzuar më 18.07.2025 deklaron angazhimin te Considion System GmbH, Mynih, nga viti 2017 e në vazhdim, në pozitën Software Developer “specializing in C#”, si dhe angazhimin te Almaviva Sap, Milano (08/2015–12/2017). Punëdhënësi, pozita dhe periudha nuk janë kontestuar nga askush dhe nuk janë ndryshuar në asnjë moment të procedurës.
9. Dëshmitë që Dosja e Tenderit i kërkon për këtë pozitë janë kopja e diplomës, CV-ja dhe kontrata e punës ose marrëveshja mbi angazhimin. Të tria janë dorëzuar brenda afatit dhe nuk janë kontestuar. Dosja e Tenderit nuk kërkon për këtë pozitë as referencë, as listë projektesh, as vërtetim punëdhënësi.
10. Një vërtetim i punëdhënësit që specifikon Microsoft SQL Server dhe projektet konkrete nuk krijon punësim, projekt apo periudhë të re – ai vetëm dëshmon teknologjinë e një angazhimi të deklaruar që nga 18.07.2025. Ky është saktësisht rasti i informatave apo dokumenteve që mungojnë, të cilat neni 38.3 lejon të kërkojnë e të merren dhe që neni 38.5 e autorizon Autoritetin Kontraktues t’i kërkojë për plotësim.
11. Ankuesi është në gjendje ta dorëzojë vërtetimin e punëdhënësit Considion System GmbH dhe i propozon Panelit Shqyrtues verifikimin e drejtpërdrejtë te punëdhënësi, konform nenit 72 të LPP-së, duke dhënë pëlqimin e plotë për këtë verifikim.
12. Eliminimi i një operatori ekonomik për mungesë të një dëshmie plotësuese, të pakërkuar nga Dosja e Tenderit dhe të cilën Autoriteti Kontraktues kishte kompetencë ta kërkonte, është joproporcional dhe ia heq efektin vetë nenit 38 të Rregullores.

5.6 Zhvilluesi i Softuerit – Ndriçim Idrizi (Kërkesa 2.b)

13. CV-ja e dorëzuar brenda afatit deklaron angazhimin te Inspired Tech SH.P.K. nga 01.11.2020 e në vazhdim. Aneksi 4 nuk shton punëdhënësi, pozitë apo periudhë të re – ai specifikon projektet dhe teknologjitë brenda të njëjtit angazhim tashmë të deklaruar.
14. Nuk ka kundërthënie teknologjike, por përshkrim jo-shterues në CV. Nën angazhimin te Inspired Tech, CV-ja përshkruan një produkt konkret (“aplikacion ERP”) së bashku me stack-un e atij produkti; ajo nuk deklaron askund se ky ka qenë i vetmi projekt i angazhimit dhe as nuk e përjashton përdorimin e C#/.NET me Microsoft SQL Server. Përkundrazi, po e njëjta CV, në seksionin e aftësive, e liston shprehimisht “MS SQL”, ndërsa nën angazhimin te TABs deklaron “JavaScript, ASP.NET and C#” dhe “Designing the database using MS SQL”. Elementi Microsoft, pra, është i deklaruar në CV brenda afatit dhe nuk është krijuar me Aneksin 4.
15. Përvoja pas diplomimit në platformën Microsoft: diplomimi Bachelor më 27.09.2012; TABs (09/2012–09/2013) me ASP.NET, C# dhe MS SQL – periudhë e pranuar edhe nga vetë Autoriteti Kontraktues; si dhe angazhimi te Inspired Tech me projektet Project Tracker (nga viti 2022), Alletta (2023–2024) dhe Blej Sigurt (nga viti 2024) në C#, .NET/ASP.NET Core dhe Microsoft SQL Server. Edhe duke e kufizuar llogaritjen vetëm te periudhat e realizuara para datës 18.07.2025, minimumi trevjeçar i kërkuar është i tejkaluar.
16. Emërtimi i pozitës nuk është kriter i Dosjes së Tenderit, e cila kërkon “përvojë pune minimum 3 vjeçare pas diplomimit, në zhvillimin e softuerit (programim)”. Dallimi ndërmjet emërtimit formal të pozitës dhe përshkrimit të punës së kryer nuk prek asnjë element material të kriterit. Ankuesi ofron dorëzimin e vërtetimit të harmonizuar dhe saktësimin e datave të fillimit e të përfundimit për secilin projekt.

17. Dallimi ndërmjet shifrës 8 në listën përmbledhëse të stafit dhe 13 vjetëve në sqarim nuk prek kriterin: dokumenti provues i kërkuar nga Dosja e Tenderit për këtë pozitë është CV-ja, ndërsa kriteri matet me përvojën pas diplomimit në platformën Microsoft, jo me përvojën totale.
18. Ankuesi nuk mbështetet në angazhimin të eLogic Ltd. (2010–2011), i cili i paraprin diplomimit; kriteri plotësohet edhe pa këtë periudhë.

5.7 Moszbatimi substancial i Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0420

Me Vendimin nr. 2026/0420, OSHP e ka obliguar Autoritetin Kontraktues të kërkojë sqarime shtesë dhe të bëjë analizimin e nevojshëm. Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar sqarimet me letrën B47, i ka pranuar dhe ka vendosur mbi to më 20.08.2026, duke i cilësuar të mjaftueshme. Refuzimi i mëvonshëm i po atyre dëshmimeve – të cilat u dorëzuan pikërisht në zbatim të urdhrit të OSHP-së – e zbraz nga efekti zbatimin e vendimit të OSHP-së dhe përbën shkelje të nenit 131 të LPP-së, në lidhje me nenet 105 dhe 117 të tij.

5.8 Shkelja e së drejtës për t'u dëgjuar

Vendimi i datës 02.09.2026 është marrë duke i pranuar në tërësi pretendimet e reja të OE PBC SH.P.K., pa i dhënë ankuesit – operatorit të rekomanduar për kontratë – asnjë mundësi për t'u deklaruar ndaj tyre. Kjo bën ndesh me qëllimin e nenit 108/A të LPP-së dhe me parimin e trajtimit të barabartë të nenit 7.

VI. DËMET MATERIALE

Me eliminimin e paligjshëm nga një procedurë në të cilën ishte rekomanduar për dhënie të kontratës, ankuesit i shkaktohen dëme materiale që përfshijnë shpenzimet e përgatitjes dhe të mbrojtjes së ofertës gjatë një procedure që zgjat mbi një vit, si dhe humbjen e fitimit të pritshëm nga kontrata me vlerë të parashikuar 168,000.00 €. Shuma e saktë do të përcaktohet me ekspertizë financiare.

VII. PROVAT

19. Vendimi i AK-së i datës 08.09.2026 mbi kërkesën për rishqyrtim të OE Inspired Tech SH.P.K.;
20. Vendimi i AK-së i datës 02.09.2026 dhe B58 – Njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 02.09.2026;
21. Njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 20.08.2026;
22. Letra Standarde B47 e kërkesës për sqarimin e tenderit, e datës 13.08.2026;
23. Sqarimi i plotë i ankuesit për kërkesat 2.a, 2.b, 2.c dhe 2.d, i dorëzuar më 17.08.2026, me Aneksat 1–5;
24. Kërkesa për rishqyrtim e ankuesit e datës 07.09.2026;
25. Dosja e Tenderit dhe oferta e ankuesit e datës 18.07.2025 (diplomat, CV-të dhe marrëveshjet e angazhimit për stafin e propozuar);
26. Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0420 i datës 22.07.2026;
27. Gjurma elektronike e platformës e-Prokurimi për aktivitetin e prokurimit nr. 206-25-4780-2-1-1, e cila dëshmon se dokumenti “B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK.pdf” është publikuar më 02.09.2026 në orën 16:10, si dhe të dhënat për njoftimin elektronik të dërguar operatorëve ekonomikë – propozohet të verifikohen drejtpërdrejt nga eksperti shqyrtues, i cili ka qasje në platformë;
28. Dëshmia e pagesës së taksës për parashtrimin e ankesës.

VIII. KËRKESA

Duke u mbështetur në faktet dhe argumentet e paraqitura më sipër, i propozojmë Panelit Shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit të nxjerrë këtë:

V E N D I M

29. APROVOHET si e bazuar ankesa e OE Inspired Tech SH.P.K.;
30. ANULOHET Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 08.09.2026 dhe konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e datës 07.09.2026 është parashtruar brenda afatit ligjor;
31. ANULOHET Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 02.09.2026 dhe B58 – Njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 02.09.2026;
32. KTHEHET aktiviteti i prokurimit në rivlerësim, me urdhër që Autoriteti Kontraktues të zbatojë nenet 38.1, 38.3 dhe 38.5 të Rregullores në mënyrë të njëtrajtshme ndaj të gjitha dëshmive të dorëzuara në përgjigje të Letrës B47, t'i mundësojë ankuesit plotësimin e dëshmisë për znj. Diana Llugaxhija dhe të kryejë verifikimin e drejtpërdrejtë të dëshmive konform nenit 72 të LPP-së;
33. URDHËROHET Autoriteti Kontraktues të pezullojë vazhdimin e aktivitetit të prokurimit, përkatësisht nënshkrimin e kontratës, deri në vendosjen përfundimtare të kësaj ankese;
34. URDHËROHET Autoriteti Kontraktues të respektojë vendimet paraprake të OSHP-së, konform nenit 131 të LPP-së në lidhje me nenet 105 dhe 117 të tij;
35. KTHEHEN mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës.

Prishtinë, më 10.09.2026

Për INSPIRED TECH SH.P.K.

Fatos Halilaj, drejtor

